

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku, kryetar i kolegjit, Shqipe Qerimi dhe Ferit Osmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hysni Ismaili, në çështjen penale kundër të akuzuarit P.T. nga ..., Republika e Sërbisë, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.566/2016 të datës 12.08.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 01.12.2016, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.566/2016 të datës 12.08.2016, **vërtetohet**.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktgjykimin P.nr.566/2016 të datës 12.08.2016, të akuzuarin P.T. e ka shpallë fajtor për veprën penale vjedhje nga neni 325 par.1. të KPRK, për të cilën e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj dhe dënimin me gjobë në shumë prej 300 €, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata do t'ia revokojë dënimin me kusht. Është detyruar i akuzuari që ti kompensojë palës së dëmtuar, M.K., në shumë prej 155 € si dhe është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcnimin e ekzekutimit të dhunshëm. I dëmtuari M.K., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil. Të akuzuarit me datë 12.08.2016 i është ndërprerë masa e paraburgimit e caktuar me aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, P.nr.566/16 të datës 22.07.2016

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, për shkak të vendimit mbi dënimin me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ankesën ta aprovoj, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj përkitazi me sanksionin penal dhe të akuzuarit ti shqiptojë dënim më të ashpër.

Prokurori i Apelit në Prishtinë me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1193/2016, datë 27.09.2016, ka propozuar që ankesa e Prokurorit të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet përkitazi me sanksionin penal dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 394 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoj pretendimet e cekura në ankesë, kolegji i kësaj Gjykate vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt komfor dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, i akuzuari P.T. në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 12.08.2016, ka pranuar fajësinë dhe gjyqtari individual është pajtuar me një pohim të tillë.

Në ankesën e Prokurorit pretendohet se gjykata e shkallës së parë të akuzuarit i ka shqiptuar dënim të ultë dhe jo adekuat në krahasim me veprën e kryer. Sipas ankesës, gjykata e shkallës së parë si rrethana lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë dhe sjelljen e të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur duke mos i vlerësuar si rrethana rënduese rrezikshmërinë shoqërore të veprës, shkallën e përgjegjësisë penale, mënyrën e kryerjes dhe dashjen.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorit për dënim më të ashpër, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë komfor dispozitës së nenit 73 të KPRK i ka vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, me ç' rast si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka vlerësuar pranimin i fajësisë, keqardhjen e shprehur, sjelljen korrekte gjatë gjykimit si dhe premtimin se të dëmtuarit do t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar

Kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e prokurorit se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është i ultë dhe se në rastin konkret nuk janë vlerësuar si rrethana rënduese rrezikshmëria shoqërore e veprës, shkalla e përgjegjësisë penale, mënyra e kryerjes dhe dashja, nuk qëndrojnë sepse faktet e cekura në ankesë paraqesin elemente të veprës penale për të cilën i akuzuari është gjykuar e jo rrethana rënduese e në anën tjetër në ankesë nuk është theksuar asnjë rrethanë rënduese që do të ndikonte në shqiptimin e dënimit më të ashpër, siç pa të drejtë pretendon Prokurori, e që nuk është vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha ato që u theksuan më lartë, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe adekuat me përgjegjësinë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit- preventiva individuale dhe ajo e përgjithshme.

Nga sa u tha më lartë, në bazë të nenit 403 të KPPR, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

PA1.nr.1158/2016 datë 01.12.2016

**Bashkëpunëtor profesional**  
**Hysni Ismaili**

Kryetari i kolegjit-gjyqtari  
1. Hashim Çollaku

**Anëtarët e kolegjit**

**2. Shqipe Qerimi**

**3. Ferit Osmani**